

VENDIM
Nr.116, datë 22.1.2004

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË NR.68,
DATE 20.2.2003

Në mbështetje të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit”, neni 14 pika 4, ndryshuar me ligjin nr.8988, datë 24.12.2002, si dhe të neneve 28 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin nr.68, datë 20.2.2003 “Për trajtimin e deputetëve” bëhen këto ndryshime:

I. Në pikën VI:

1. Fjalja e parë e paragrafit të parë ndryshohet si më poshtë:

“Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve në përdorim të deputetëve bëhet nga administrata e Kuvendit të Shqipërisë”.

2. Paragrafi i dytë shfuqizohet.

II. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë në vitin 2004, pas përfundimit të procedurave të prokurimit me objekt mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve të Kuvendit të Shqipërisë.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi